



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim Uprava za Obrazovanje//Department of Education

Nr.prot:05/665

Datë 10.08.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar, si dhe në kuadër të kompetencave të Drejtorisë Komunale të Arsimit, nxirret ky:

VENDIM

I. Anulohet konkursi publik nr. prot. 02-111/01-0012223/26, datë 18.06.2026, dhe nr. prot. 05/463 **RN00019897**, për plotësimin e tri (3) pozitave të asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Shtimes.

II. Konkursi nga pika I e këtij vendimi anulohet për shkak të pamundësisë për të garantuar verifikimin dhe trajtimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha aplikimeve të paraqitura gjatë afatit të konkursit, në pajtim me mënyrën e aplikimit të përcaktuar në konkurs.

III. Me anulimin e konkursit nga pika I e këtij vendimi, ndërpritet procedura e mëtejshme e përzgjedhjes për tri (3) pozitat e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Për plotësimin e këtyre pozitave do të zhvillohet procedurë e re e rekrutimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

IV. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për shpalljen e konkursit të ri, në pajtim me procedurat dhe afatet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

V. Ky vendim do të publikohet në Portalin Shtetëror për Rekrutimin e Nëpunësve Publikë dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur konkursin publik për plotësimin e tri (3) pozitave të asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, ku është përcaktuar

që dokumentacioni për aplikim të dorëzohet në mënyrë elektronike, në adresën e përcaktuar në konkurs. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve janë paraqitur disa raste në të cilat aplikuesit kanë ofruar dëshmi elektronike se aplikimet e tyre janë dërguar brenda afatit të përcaktuar në konkurs, në adresën elektronike të përcaktuar në shpallje. Megjithatë, këto aplikime nuk janë evidentuar në adresën elektronike zyrtare të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Duke pasur parasysh këto rrethana, si dhe nevojën për të siguruar që të gjitha aplikimet e paraqitura në mënyrën e përcaktuar në konkurs të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe transparente, është vlerësuar se vazhdimi i procedurës ekzistuese nuk ofron garanci të mjaftueshme për përfshirjen dhe verifikimin e të gjitha aplikimeve të mundshme të dorëzuara brenda afatit.

Për këtë arsye, me qëllim të sigurimit të një procedure të rregullt, transparente dhe të barabartë për të gjithë kandidatët, është vendosur anulimi i konkursit dhe zhvillimi i një procedure të re të rekrutimit.

Bazuar në sa më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit

Një kopje dorëzohet
Njësia për Burime Njerëzore
Publikim në portalin shtetëror
Publikim në ueb faqen zyrtare të komunës

